



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Pukë, më 08 .09 .2025

Nr. 1482/3 prot.

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
date 04 .09 .2025

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 5 datë 28.08.2025, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë u zhvillua me datën 04 .09 .2025 ,ora 13-³⁰ tek sala e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite: :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 25.07.2025
2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Korrik** 2025.
3. Projekt- vendim : Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor.
4. Projekt-vendim " Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e Personit Juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë , për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të Republikës së Shqipërisë (TALGA)
- 5.Projekt-vendim : Për shtyrjen e afatit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022-2025 me një vit shtesë
6. Projekt-vendim "Për miratimin e planit social të Bashkisë Pukë 2025-2028



7. Projekt-vendim : "Per miratimin e planit per Arsimin Parauniversitar 2025-2028"

8. Projekt-vendim : Për miratimin projektit me objekt "Masa parandaluese të gerryerjes së tokave bujqësore nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre , fshati Gomsiqe, Njësia administrative Qerret, Bashkia Pukë" me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

9. Projekt-vendim: Për miratimin e projektit me objekt : " Masa rehabilituese të bodrumit të pallatit nr.50 , i dëmtuar nga ujrat e zeza, Njësia administrative Pukë, Bashkia Pukë, me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

10. Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Rrok Dodaj , kryetari i Bashkise, Ferit Rringaj , zv/kryetari i Bashkise, Lavdie Terbuni, pergjegjese e zyres sociale , Sokol Gjoni , drejtor i burimeve njerezore, Fiqirete Latifi. Drejtore e Finances, Dhurata Risto , drejtore e Turizmit , etj

Mbledhja filloi ne oren 13:³⁰ . Jane prezent ne mbledhje 9 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes. (ne oren 14:00 erdhi dhe keshilltari Arben Guga)

Kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka hapi mbledhjen dhe prezantoi projekt-rendin e dites te miratuar nga kryesia.

Pas diskutimit te anetareve, u hodh ne votim dhe u miratua rendi i dites me 9 vota pro, 0 ,vota kunder, 0 vota abstenim.

1. Mbledhja vijoi me **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 25.07.2025**

U hodh ne votim dhe u miratua **procesverbali i mbledhjes së dates 25 .07.2025** me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.



2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Korrik** 2025.

Pyetje : Gjon Gjoka: A ka ndryshime nga muaj paraardhes? A kane ngele jashte liste familje te tjera?

Sqaron : Lavdie Terbuni: Jane ndryshime te paperfillshme, jashte liste ka , por eshte e pamundur te perfshihen se buxheti eshte i limituar.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **Korrik** 2025. me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

3. Projekt- vendim : Për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor.

Pyetje : nuk ka

Sqaron : Fiqirete Latifi : Eshte sipas udhezimeve perkatese, te sqaruara ne relacionin e paraqitur. Jane verifikuar rast pas rasti, disa rezultojne te mbyllura si aktivitete. Kemi bere kerkese per plotesim dokumentacioni, por nuk kemi patur reagim.

U hodh ne votim dhe u miratua projekti: për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura, që nuk justifikohen me dokumentacion financiar dhe ligjor me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

4. Projekt-vendim " Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e Personit Juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njërive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë , për rritjen e kapaciteteve



të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore,
të Republikës së Shqipërisë (TALGA)

Pyetje: nuk ka

Sqaron : Sokol Gjoni : Eshte projekt-vendim standard per te gjitha Bashkite.

Keshilli e miraton dhe autorizon Kryetarin e Bashkise per veprime te tjera.

U hodh ne votim dhe u miratua projekti : Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e Personit Juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë , për rritjen e kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të Republikës së Shqipërisë (TALGA) me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

5. Projekt-vendim : Për shtyrjen e afatit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022-2025 me një vit shtesë.

Sqaron : Sokol Gjoni : Jemi ne kushtet kur dokumentet strategjike kane afate me te gjata se 1 vit, kemi nevojë për ta finalizuar kete dokument me me shume rezultate , për transparencën dhe integritetin e administratës për me shume kohe në dispozicion.

U hodh në votim dhe u miratua **shtyrja e afatit** të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022-2025 me një vit shtesë me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

6. Projekt-vendim "Për miratimin e planit social të Bashkisë Pukë 2025-2028

Sqaron : Lavdie Terbuni : Po paraqesim planin social , për hartimin e të cilit kemi bashkëpunuar me disa organizata dhe kemi shfrytëzuar eksperiencat e bashkive të



tjera. Kemi ndjekur disa hapa perfshire edhe degjesat publike, ku mendime dhe opinionet e grupeve te interesit jane perfshire ne plan. Zbatimi i ketij plani do te kontriboje per nje shoqeri te drejte, cilesore dhe te qendrueshme.

Perfshirja e familjeve ne qendren komunitare, aksesit i shtresa sociale vulnerable, perfshirja ne projektet sociale, puna me viktimat e dhunes ne familje, zhvillimi i fushatave ndergjegjesuese, kujdesi per te moshuarit e vetmuar dhe ne nevoje.

Besmira Aliaj: Sa % e buxhetit te bashkise mbulon zbatimin e planit?

Lavdie Terbuni: Per kete vit nuk ka buxhet te destinuar, ne vijim do te planifikojme.

F. Ringaj: Jane dokumenta strategjike, jane bere ne bashkepunim me organizata dhe donator, sepse financat e bashkise nuk e mbulojne dot. Na kane ndihmuar Bashkise e forta, drejtuesit e shkollave etj.

U hodh ne votim dhe u miratua **Plani social i Bashkisë Pukë 2025-2028** me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

7. Projekt-vendim : "Per miratimin e planit per Arsimin Parauniversitar 2025-2028"

Pyetje : Sh. Pemaj: Si do te ndikohet ne permiresimin e mesimdhenies?

Sqaron : Sokol Gjoni : permiresimi i infrastruktures, rritja e sigurise do te ndikojne pozitivisht.

F. Ringaj: Jane dokumenta strategjike, jane bere ne bashkepunim me organizata dhe donator, sepse financat e bashkise nuk e mbulojne dot. Na kane ndihmuar Bashkise e forta, drejtuesit e shkollave etj.

U hodh ne votim dhe u miratua **Plani** per Arsimin Parauniversitar 2025-2028 me 10 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

8. Projekt-vendim : Për miratimin projektit me objekt "Masa parandaluese të gerryerjes së tokave bujqësore nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre, fshati Gomsiqe, Njësia administrative Qerret, Bashkia Pukë" me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.



Diskutime: F. Rringaj : Eshte kerkese e kahershme sepse rrezikohet gerryerja e tokave, do te behet nderhyrje siper rruges me prita malore per te mbrojtur tokat dhe rrugen. Kemi shume projekte ne proces , te cilat presin financimin.

Gj. Gjoka : Jemi shume dakord.

B. Aliaj: Eshte emergjente , por kemi edhume gjera te tjera elementare, mbeturinat, ndricimi. Lagjia Kukaj eshte lagje me shume banore, duhet te realizohen disa sherbime te nevojshme.

F. Rringaj: Projekti per lidhjen e te dy rezervuaret do te zgjidh shum probleme.

Rr. Dodaj: Jemi ne proces me fondin e zhvillimit, filluam me fasadat e pallateve, me materialet ndihmese ne infrastrukturen e fshatrave dhe do te vijojme me ndricimin ne periferi dhe ne fshatra. Keme bere projektin per dy licenet me fondet e bashkise.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti me objekt "Masa parandaluese të gerryerjes së tokave bujqësore nga ujrat e larta dhe sistemimi i tyre , fshati Gomsiqe, Njësia administrative Qerret, Bashkia Pukë" me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile. me 9 vota pro, 0 vota kunder, 1 vote abstenim.

9. Projekt-vendim: Për miratimin e projektit me objekt : " Masa rehabilituese të bodrumit të pallatit nr.50 , i dëmtuar nga ujrat e zeza, Njësia administrative Pukë, Bashkia Pukë, me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

Diskutime:

Rr. Dodaj: Duhet te sqarojme se fondet e emergjencave civile nuk mund te perdoren per sherbime. Kemi hartuar disa plane , sic eshte ai i menaxhimit te pyjeve dhe do te arrijme te perfitojme financime per te kapercyer veshtersite e krijuara.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekti me objekt "Masa parandaluese të bodrumit të pallatit nr.50 , i dëmtuar nga ujrat e zeza, Njësia administrative Pukë, Bashkia Pukë, me fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile me 10 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.



10. Te tjera:

- Kerkese e z. Prend Marku , ne emer te banoreve te Pallatit te Termetit,

Ketij pallati i eshte hequr interkapeti gjate nderhyrjes per fasadat nga Bashkia e meparshme dhe uji deperton brenda ne banesa.

Rr. Dodaj: do te behet me vazhdimin e procesit te fasadave me sistem kapot ne fazen ne vijim.

Sh. Pemaj : Duhet te nderhyhet ne fasaden e shkolles se mesme.

Kerkesa e Markut ne Dedaj per hapjen e rruges auto.

Rr. Dodaj: Keme bere verifikimet e duhura , por kjo rruge ka probleme sociale dhe te pronesise, por banoret kane te drejte. Kam kerkuar zgjidhjen miqesore, ose ndonje mundesi tjeter per te kaluar.

A. Guga: Kur ka pas nevojje ka marre leje , duhet marreveshje ndermjet familjeve per te evituar konfliktet.

Se pari te behet nje vendimmarrje e kryesise se fshatit Dedaj, pastaj ta diskutojme.







-Kerkese e kryetarit te fshatit Midhe-Tmug per riparimin e ures dhe rruges .


Rr. Dodaj: rruga eshte e demtuar po keshtu dhe ura, do te nderhyjme per ta riparuar.

- Kerkese e Z. Xhemal Laci , lagjia Lacaj Puke. Kerkon hapjen e rruges per te shkuar ne shtepi. Rruga eshte bllokuar nga Aleksander Laci, komshi.

Ngarkohet administrata e Bashkise ta verifikoje dhe te raportoje ne keshille me propozim konkret.



ALFONS	GJERGJAS	
Edvard	Gjoka	
Desmina	Aliq	
Aleksander	Thoku	
Harlan	Luqaj	
Shpresa	Pemaj	
Ndue	Colaj	
Alban	Harh	
Benson	Kushi	
Goga	Gjoka	

Sekretari i bashkisë
 Hazbi Terkani



Lista e këshilltareve ne mbledhjen e dates : 04.09 .2025

Emri	Mbiemri	Firma	Verejtje
1.Gjon	Gjoka	<i>Gjon Gjoka</i>	
2. Enver	Sulejmani		
3. Ndue	Lalaj	<i>Ndue Lalaj</i>	
4. Arben	Gugaj	<i>Arben Gugaj</i>	<i>ordhi me datën 14.09.2025</i>
5. Besmira	Aliaj	<i>Besmira Aliaj</i>	
6. Shpresa	Pemaj	<i>Shpresa Pemaj</i>	
7. Edmond	Luka		
8. Alfons	Gjergjaj	<i>Alfons Gjergjaj</i>	
9. Dritan	Asani		
10. Besar	Kuçi	<i>Besar Kuçi</i>	
11.Aida	Cenaj		
12.Aleksander	Frroku	<i>Aleksander Frroku</i>	
13. Eduard	Gjoka	<i>Eduard Gjoka</i>	
14. Alban	Lleshi	<i>Alban Lleshi</i>	
15. Leze	Kolaj		

